



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4866 / Prot.
1

Tiranë, më 20. 7. 2022

URDHËR

Nr. 437, datë 20. 7. 2022

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN
DHE ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E
RREGULLUAR TË MËSUESIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 57, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në rregulloren bashkëlidhur urdhrit nr. 100, datë 25.2.2022 "Për miratimin e rregulloreve për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Evis KUSHI





MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4866/12 Prot.

Tiranë, më 20. 7. 2022

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT

1. Pika 1 e nenit 16 ndryshon si vijon:

"1. Kohëzgjatja e praktikës profesionale që kryhet nga praktikanti është një periudhë mësimore".

2. Shkronja d, e nenit 18 ndryshon si vijon:

a) *"Projektin kurrikular të nxënësit (1-2 modele)".*

3. Pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 19, ndryshojnë si vijon:

- "1. Praktikanti që ka munguar me shumë se 30% të orëve mësimore të kohës së përcaktuar për realizimin e praktikës, përsërit të plotë praktikën profesionale.*
- 2. Praktikantit që ka munguar 20-30% të orëve mësimore të kohës së përcaktuar për realizimin e praktikës, i shtyhet praktika 1 muaj.*
- 3. Praktikanti që ka munguar më pak se 20% të orëve mësimore të kohës së përcaktuar për realizimin e praktikës, i nënshtrohet vlerësimit."*

4. Në nenin 20, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 1, ndryshohet me këtë përmbajtje:

"1. Për vlerësimin e praktikantëve ngrihet Komisioni i vlerësimit të praktikantëve (ne vijim Komisioni) me vendim të drejtuesit të ZVAP-së. Komisioni kryesohet nga përgjegjësi i sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional dhe përbëhet nga një specialist i këtij sektori, një specialist jurist, një drejtor IAPP-je dhe një kryetar ekipi lëndor përkatës."

b) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, si vijon:

"1/1. Brenda një afati 30 ditor nga data e përfundimit të praktikës profesionale nga praktikantët drejtorja e institucionit arsimor ku praktikantët kanë kryer

praktikën dhe ZVAP organizon, realizon dhe përfundon procedurat për vlerësimin e praktikantëve.”.

c) Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Komisioni vlerëson “Dobët” praktikantin, kur në të paktën një kompetencë ka vlerësimin “Dobët”. Në këtë rast, komisioni shtyn afatin e zhvillimit të praktikës profesionale me një muaj. Shtyrja prej një muaji mund të përsëritet deri në tri herë. Praktikanti mund të zhvillojë praktikën profesionale në të njëjtin institucion arsimor.”.

d) Në pikën 4, në fund të fjalisë së dytë, togfjalëshi “*në një vit shkollor*” zëvendësohet me togfjalëshin “*në një periudhë mësimore.*”.

5. Në shtojcën 2 bëhen ndryshimet si vijon:

- a) Në rubrikën “*PLOTËSIMI SISTEMATIK I TABELAVE TË KOMPETENCAVE*”, Kompetenca 4, “*muajt*”, të zëvendësohen me “*periudhë mësimore*”.
- b) Në rubrikën “*PRAKTIKANTI SI MËSUES NDIHMËS*”, togfjalëshi “*vlerësimin e portofoleve të nxënësve*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*vlerësimin e projekteve të nxënësve*”.

6. Në shtojcën 3, në treguesin nr. 4, te Kompetenca 5, fjala “*portofolin*” të zëvendësohet me fjalën “*projektin*”.

7. Në pjesën “*Udhëzime*” bëhen ndryshimet si vijon:

- a) Në treguesin nr. 2, të Kompetencës 3, togfjalëshi “*gjatë vitit shkollor*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*gjatë periudhës mësimore*”.
- b) Treguesi nr. 2, i Kompetencës 4, ndryshon me këtë përmbajtje:
***“Nxënësit punojnë dhe përditësojnë rregullisht projektin e tyre.
Projekti kurrikular shtrihet në një ose më shumë fusha të nxëni dhe mund të zhvillohet individualisht ose në grup”.***